

Lokalizimi i Axfordës

Gusht 2021

Autorë:
Agron Haxhimali dhe Aida Cacaj,
Shoqata e Bashkive

Ky publikim është përgatitur nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe me mbështetjen financiare të Fondacionit Hanns Seidel, Shqipëri. Ky botim pasqyron qëndrimet e Shoqatës së Bashkive dhe jo domosdoshmërisht të Fondacionit Hanns Seidel. Autorët garantojnë pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra nga materialet e referencës të përdorura.



SHOQATA E BASHKIVE TË SHQIPËRISË



FONDACIONI HANNS-SEIDEL

Tabelë e Përmbajtjes

Axhenda e vitit 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.....	4
Lokalizimi i Axhendës 2030.....	4
Qëllimi i Manualit.....	6
Struktura e manualit.....	6
Pjesa e parë e Manualit:	6
Pjesa e dytë e Manualit:.....	6
Pjesa e tretë e Manualit:.....	7
Pjesa 1: Monitorimi i OZhQ në nivel vendor	8
Vlerësimi Vullnetar Lokal	8
Hulumtim në sistemet e monitorimit të SDG	10
Sfidat e gjetjes dhe përpunimit të të dhënave për njësitë vendore	10
Komponentët kryesorë të VVL.....	11
Disa seksione të identifikuara në VVL botuar në dy vitet e fundit.....	12
Metodologjia për zgjedhjen e treguesve	12
Llojet e treguesve të propozuar	13
Pjesa 2: Dimensioni lokal i Axhendës 2030	14
Vlerësimi Vullnetar Lokal për Bashkinë Shkodër	39

Axhenda e vitit 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në vitin 2015, udhëheqësit botërorë ranë dakord për një axhendë të re për arritjen e zhvillimit global të qëndrueshëm deri në 2030. Rezultati i dy vite negociatash brenda bashkësisë ndërkombëtare ishte Rezoluta e Përgjithshme e Asamblesë: "Transformimi i Botës Sonë: Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm" (Kombet e Bashkuara 2015). Axhenda përcakton 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) dhe identifikon si përparësi të parë çrrënjosjen e varfërisë në të gjitha format dhe dimensionet.

Shqipëria dhe 192 shtete të tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara në shtator 2015, miratuan Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Axhenda e vitit 2030 është një kornizë globale 15-vjeçare e përqendruar në 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), 169 synime dhe mbi 230 tregues¹.

Në vitin 2016, një vit pas miratimit të Axhendës, konteksti urban mori një rëndësi të theksuar në debatin mbi politika të ndryshme. Kjo solli që në 2016 Kombet e Bashkuara të miratonin një axhendë specifike për qytetet, Axhenda e Re Urbane (ARU). Paralelisht me procesin e negocimit për ARU, Shtetet Anëtare të BE arritën konsensus për miratimin e saj në nivel evropian përmes Paktit të Amsterdami, për krijimin e "Axhendës Urbane për BE". Kjo axhendë e re përcakton përparësitë specifike dhe fushat e veprimit për qytetet evropiane, në mënyrë që të përmirësohet zhvillimi urbanistik përmes dialogut në shumë nivele dhe partneritetit.

Lokalizimi i Axhendës 2030

Falë advokimit të bërë nga aktorë të ndryshëm, OZhQ-të përfshijnë një objektiv specifik për urbanizimin. Objektiv 11 synon kthimin e qyteteve dhe vendbanimeve në gjithëpërfshirës, të parrezikshëm, rezistues dhe të qëndrueshëm. Përveç fokusit specifik urban të OZhQ 11, urbanizimi është shënjestruar drejtpërdrejt në të paktën njëmbëdhjetë OZhQ të tjerë.

Në këtë kuadër qeveria shqiptare është e angazhuar në vijimin e planeve dhe projekteve për t'i bërë realitet Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Për më tepër, rreth një e treta e 232 treguesve të OZhQ mund të maten në nivelin lokal, duke e bërë këtë nivel njësi të rëndësishme për veprim dhe monitorim të progresit drejt zhvillimit të qëndrueshëm²

¹ <https://unstats.un.org/sdqs/iaeq-sdqs/tier-classification/>

² (UN-Habitat 2018a, 10–11)

Midis profesionistëve të pushtetit vendor ekziston konsensusi mbi dimensionin lokal i OZhQ-ve dhe që bashkitë nuk janë thjesht agjenci zbatuese por sfidat e tyre dhe mundësitë për arritjen e OZhQ -ve meritojnë konsideratë speciale. Në fakt, 65 përqind e axhendës së OZhQ mund të mos arrihet plotësisht pa përfshirjen e aktorëve lokalë³.

Lokalizimi i OZhQ-ve është edhe më i rëndësishëm në nivel lokal, ku gjenerohet pjesa më e madhe e PBB-së dhe ku politikat dhe legjislacioni zbatohen. Duke u bazuar në përvojën të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Kombet e Bashkuara njohën iniciativat e bashkëpunimit të zhvillimit të decentralizuar dhe bashkëpunimin ndërbashkiak si mekanizma me kosto efektive.

Qytetet janë në zemër sfidave të të sotmes, qofshin ekonomike, mjedisore apo sociale. Më shumë se 70% e qytetarëve të BE-së jetojnë në zona urbane ndërsa rreth 85% e PBB të BE-së gjenerohet në qytete. Këto zona urbane janë motorët e ekonomisë evropiane dhe veprojnë si katalizatorë për zgjidhje të qëndrueshme innovative që promovojnë shndërrimin në një shoqëri me karbon të ulët dhe të qëndrueshme.

Sidoqoftë, ato janë gjithashtu vende ku probleme të tilla si papunësia, dallimet, varfëria dhe ndotja janë në më të pranishmet.

Komisioni Evropian 2016

³ Adelphi dhe Urban Catalyst 2015

Qëllimi i Manualit

Qëllimi i këtij manuali është të ofrojë mbështetje për bashkitë që janë të gatshme të përgatisin Vlerësime Vullnetare Lokale (VLR) të OZhQ. Manuali është krijuar për të qenë një udhëzues për zgjedhjen e treguesve të duhur për t'u përdorur në vlerësim dhe për ta përshtatur vlerësimin me situatat dhe sfidat lokale.

“Lokalizimi i referohet procesit të përcaktimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjive në nivel lokal për arritjen globale, kombëtare dhe nënkombëtare të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo përfshin mekanizma konkretë, mjete, platforma dhe procese inovatore për të përkthyer në mënyrë efektive axhendën e zhvillimit në rezultate në nivelin lokal.

Prandaj koncepti duhet kuptuar në mënyrë holistike, përtej institucioneve të qeverive lokale, për të përfshirë të gjithë aktorët lokalë përmes një qasje territoriale që përfshin shoqërinë civile, organizatat fetare, akademinë, sektorin privat dhe të tjerë.”

Grupi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara 2014

Për më tepër, në sajë të manualit do të mundësojnë kuptimin më të mirë të kontekstit të OZhQ në Shqipëri, lidhjet midis tyre dhe veprimet lokale që mbështesin komunitetin global në arritjen e Qëllimeve. Manuali sugjeron përdorimin e gjetjeve të bazuara në procesin e rishikimit për të nxitur vendim-marrje më të mire dhe arritjen e OZhQ në nivelin lokal.

Metodologjia për përzgjedhjen e treguesve ilustron llojet e ndryshme të treguesve dhe kriteret e përdorura për zgjedhjen e tyre.

Struktura e manualit

Pjesa e parë e Manualit:

- ilustron çështjet që lidhen me monitorimin e OZhQ në shkallë lokale;
- ofron një përmbledhje të sistemeve të monitorimit të OZhQ;
- thekson sfidat kryesore për autoritetet lokale në mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e treguesve;
- ilustron përbërësit kryesorë të VVL-ve;
- ilustron metodologjinë e përdorur për përzgjedhjen të treguesve që përmbahen në këtë manual.

Pjesa e dytë e Manualit:

- paraqet një grup të treguesve që mund të përdoren për VLR-të sipas në një grup kriteresh. Çdo Objektiv prezantohet nga:
 - përshkrimin e qëllimit;
 - dimensionin evropian të qëllimit;

- dimensionin lokal të qëllimit.

Treguesit e sugjeruar, si zyrtarë ashtu edhe eksperimentalë, identifikohen sipas rëndësisë në nivelin lokal dhe disponueshmëria e të dhënave në administratat lokale.

Pjesa e tretë e Manualit:

- Vlerësimi Vullnetar Lokal për Bashkinë Shkodër

Pjesa 1: Monitorimi i OZhQ në nivel vendor

Vlerësimi Vullnetar Lokal

Çfarë është një vlerësimi vullnetar lokal?

Vlerësimi Vullnetar Lokal është një mjet që lejon bashkitë të vlerësojnë arritjet e tyre në përmbushjen e OZhQ dhe kontributi i tyre në Axhendën 2030. Gjithashtu u mundëson qyteteve që t'i japin përparësi veprimeve dhe ngritjes së ndërgjegjësimit për qëndrueshmërinë në administratë dhe komunitet lokal.

Deininger (2019) përcakton Vlerësimin Lokal Vullnetar si “një mjet për qeveritë qendrore dhe lokale për të raportuar progresin e tyre drejt OZhQ”, duke nënvizuar se procesi përfshin palë të ndryshme të interesuara.

Një nga mësimet e nxjerra gjatë kalimit nga Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) tek OZhQ është se përfshirja e qeverive lokale është thelbësore si në përkufizim dhe në arritjen e qëllimeve. Më konkretisht, nevoja për ndërtimin e kapaciteteve statistikore dhe mekanizmave që forcojnë mbledhjen e të dhënave të ndara në nivelin lokal janë identifikuar si një nga çështjet kryesore për tu adresuar.

Axhenda e vitit 2030 synon një botë pa varfëri dhe uri, me arsim cilësor, mbulim shëndetësor universal, arritje të barazisë gjinore dhe fuqizim të grave dhe vajzave, dhe me një mjedis të qëndrueshëm.

Pas miratimit të Axhendës 2030, disa qytete kanë filluar të punojnë për të vlerësuar kontributin e tyre drejt OZhQ. E para njësi e qeverisjes vendore (rajonale) që botoi një VVL ishte Kantoni Bask (Spanjë) në vitin 2017 pasuar me një tjetër në 2018.

Një nga qytetet e para që kaloi vijën e finishit ishte Neë York City, që prezantoi publikisht VVL-në e tij të parë në Forumin Politik të Nivelit të Lartë (HLPF) në 2018⁴ (Qyteti i Neë York 2018) dhe një të dytë në 2019.

Vlerësimi vullnetar lokal i New York City, si dhe të tjerët që pasuan (Helsinki) kryesisht u bazuan tek Vlerësimet Vullnetarë Kombëtare, duke ndjekur të njëjtën strukturë raportimi vetëm në pesë OZhQ nën rishikim në Forumin e Lartë Politik të atij viti. Edhe pse Vlerësimet Kombëtare mund të shërbejnë si referencë, proceset që duhet të ndiqen nga bashkitë përfshijnë palë interesi të ndryshme dhe duhet të përshtaten dhe ndërtohen në përputhje me strukturën e qeverisjes vendore.

Rrjetet dhe shoqatat e qeverisjeve vendore kanë ndërmarrë veprime për lokalizimin e Axhendës 2030 si në të gjithë botën dhe rajonalisht që nga viti 2015. Ndërsa mbështesnin anëtarësinë e tyre, ata kanë prodhuar botime, trajnime dhe analiza në mbështetje të proceseve. Shembujt përkatës janë Task Forcat Globale të UCLG dhe CoR (Task Forca e Qeverive Lokale dhe Rajonale 2016); Task Forca Globale e Qeverive Lokale dhe Rajonale 2018; Komiteti Evropian i Rajoneve - Komisioni për Politikën Evropiane 2019).

⁴ Në krahasim me Deklaratën e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (Kombet e Bashkuara 2000) dhe qëllimet e aprovuara në 2000, OZhQ-të janë krijuar që të jenë të zbatueshme dhe të mbulojnë në mënyrë universal sfidat globale.

Pse bashkia duhet të shpenzojë kohë dhe burime për të prodhuar një VVL?

Pregatitja e VVL-ve në nivel vendor i shërben një qëllimi të dyfishtë: nga njëra anë, mund të ndihmojë bashkinë të vlerësojë arritjet e veta për OZhQ; nga ana tjetër, nëse bëhet në një mënyrë të harmonizuar në shkallë kombëtare, mund të mundësojë vlerësimin në nivel kombëtar të kontributit të qyteteve në arritjen objektivave të Axfordës 2030.

Vendet me një nivel të lartë të ndërgjegjësimit për rëndësinë e zbatimit lokal të OZhQ dhe të bashkëpunimit ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes me palët e interesuara do të përfitonin më së shumti nga ky proces, si në zbatim ashtu edhe monitorimin, por edhe në rishikimin dhe ripërcaktimin e politikave.

Për bashkinë, vlera e shtuar është më shumë në proces, sesa në produkt, pasi proceset e përdorura ndihmojnë administratat lokale për të forcuar lidhjet me palët e interesuara dhe nxisin bashkëpunimin ndërmjet departamenteve të ndryshme.

Për shembull, përgatitja e VVL kërkon disa hapa dhe ndërveprime me një numër aktorësh lokalë, nga komunitetet lokale, akademja, sektori privat, shoqëria civile dhe OJQ, ndër të tjera. Ky nivel i bashkëpunimit është i nevojshëm edhe brenda administratës: analiza e strategjisë së një bashkie dhe hartëzimi i veprimeve strategjike drejt OZhQ kërkon pjesëmarrjen e të gjithë sektorëve. Një bashkëpunim më efikas gjithashtu kërkohet mes niveleve të ndryshme të qeverisjes që nga përzgjedhja e treguesve që mund të mbështesin OZhQ deri tek monitorimi në nivelin lokal. Departamente të ndryshme, në përgjithësi, mbledhin lloje të ndryshme të të dhënave (përfshirë të dhëna administrative) dhe kërkohet përpjekje për t'i bashkuar ato në një bazë të dhënash të integruar.

Ky nivel i bashkëpunimit është i nevojshëm edhe brenda vetë administratës: analiza e strategjisë së bashkisë dhe hartëzimi i veprimeve strategjike drejt OZhQ kërkon pjesëmarrjen e të gjitha drejtorive dhe sektorëve. Një bashkëpunim i brendshëm më efikas kërkohet në përzgjedhjen e treguesve që mund të mbështesin OZhQ dhe monitorimin e tyre në nivelin lokal. Drejtori të ndryshme, në përgjithësi, mbledhin lloje të ndryshme të të dhënave (përfshirë të dhëna administrative) dhe kërkohet punë për t'i bashkuar ato në një bazë të dhënash të integruar.

Për shembull, në rastin e Madridit, për identifikimin e treguesve dhe hartëzimit të qëllimeve strategjike të bashkisë drejt OZhQ është nxitur bashkëpunimi i brendshëm nëpër drejtori të ndryshme brenda bashkisë. Prandaj, VVL mund të konsiderohet një produkt që integron dhe përmbledh veprimet më të mira dhe më transformuese të përzgjedhura në vend nga administrata.

Nga njëra anë VVL ofron një mundësi për qeveritë lokale për të ilustruar transformimin dhe arritjet e fituara, nga ana tjetër nxjerr në pah fushat ku veprimet më urgjente janë të nevojshme. VVL mund të jenë të dobishme për të identifikuar prioritetet dhe përcaktuar më mirë fushat e mundshme të veprimit për ta bërë një bashki më të qëndrueshme ekonomikisht, nga ana sociale dhe mjedisore.

Procesi i hartimit të VVL mund të shërbejë gjithashtu si një mjet për të ndërgjegjësuar administratën rreth qëndrueshmërisë dhe shumëllojshmërisë së efekteve të veprimeve lokale drejt OZhQ të ndryshme. Nga hulumtimet e deritanishme, shumë njësi të qeverisjes lokale kanë theksuar nevojat për trajnim të

nëpunësve civilë lokalë mbi marrëveshjet ndërkombëtare siç është Axhenda 2030 dhe lidhjes midis veprimeve lokale dhe sfidave globale.

Puna e bërë nga shoqatat e qeverisjes vendore në vende të ndryshme ka përgatitur terrenin për lokalizimin e OZhQ-ve. Për qytetet evropiane dhe shoqatat e tyre, CMER përfaqëson një pikë reference për mbledhjen e informacionit dhe ndarjen e praktikave më të mira në këtë temë. Midis tyre, një përvojë interesante është puna e bërë nga Shoqata e Komunave Hollandeze (VNG) si në drejtim të ndërgjegjësimit dhe të identifikimit të treguesve për monitorimin lokal të OZhQ.

Hulumtim në sistemet e monitorimit të SDG

Politikat e mirëinformuara janë kritike për veprime të sukseshme. Çdo vit, Kombet e Bashkuara botojnë Raporti e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe vlerësimin e tyre në shkallë globale⁵. Raporti është një analizë e përmbledhur e statistikave të grumbulluara nga Shtetet Anëtare të OKB.

Një element kryesor i vlerësimit është pasja e të dhënave të besueshme dhe relevante për të vlerësuar Axhendën 2030. Ky sistem raportimi është krijuar për të përfshirë qeveritë në Axhendën 2030 dhe për ti bërë ata të përgjegjshëm për veprimet e tyre. Brenda këtij proces, dimensionin lokal i OZhQ nuk merret direkt në konsideratë dhe është akoma në shqyrtim se si vendet të integrojnë kornizat e raportimit nga institucionet e tjera (autoritetet lokale, por edhe korporatat, OJQ-të dhe shoqëria civile). Një veçanti është organizimi një ditor "Veprimi Lokal për Angazhimet Globale" që u organizua për të diskutuar këtë temë gjatë Forumit të Nivelit të Lartë Politik (Kombet e Bashkuara 2019).

VVL janë aplikuar si përkthim në shkallë lokale të Vlerësimeve Kombëtare Vullnetare (VVK). Në të vërtetë, shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara që dëshirojnë të përgatisin një VVK duhet të ndjekin udhëzimet e dhëna nga Kombet e Bashkuara (Grupi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim 2016; UNDSO dhe UNDESA 2018; Departamenti i Kombeve të Bashkuara të Çështjeve Ekonomike dhe Sociale 2018), dhe inkurajohen të përdorin treguesit zyrtarë të OZhQ.

Sidoqoftë, bashkitë mund të mbështeten në ato pak përvoja ekzistuese të raportimit të dizajnuara për përdorim në shkallë vendi, dhe pse nuk mund të përshtatet lehtë me nivelin lokal. Ajo që doli qartë në debatin rreth lokalizimit të OZHQ është se ka një thirrje për veprim lokal dhe se qytetet kanë filluar të reagojnë. Ndërsa metodat për të integruar Vlerësimet Lokale në ato Kombëtare janë ende në diskutim, bashkitë po fillojnë të raportojnë në lidhje me OZhQ. Megjithatë, ende mungon një kuadër i dakortësuar se si ta bëjmë këtë dhe më tej si t'i bëjmë këto përpjekje të krahueshme. Kjo është madje gjëja më e rëndësishme sepse mesazhet kombëtare mund të fshehin pabarazitë midis bashkive dhe qarqeve brenda vendit dhe sepse kjo përpjekje mund të përmirësojë aftësinë e qeverive lokale për të vetëvlerësuar rrugën e tyre drejt qëndrueshmërisë.

Sfidat e gjetjes dhe përpunimit të të dhënave për njësitë vendore

⁵ United Nations 2016b, 2017, 2018, 2019b

Njësitë vendore përballen me disa vështirësi në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për të matur progresin e tyre në arritjen e OZhQ. Disa çështje dhe pyetjet dolën nga kërkimet gjatë përgatitjes së këtij botimi:

- Ka mungesë të kapaciteteve njerëzore ose stafit të trajnuar në bashki për të mbledhur dhe shpërndarë të dhëna, si dhe burime të pamjaftueshme financiare për të grumbulluar të dhëna për një hapësirë të madhe gjeografike dhe për një afat të gjatë;
- Roli i bashkive në arritjen e OZhQ, përcaktohet nga nivele të ndryshme të qeverisjes në përputhje me kuadrin mbi të cilin janë hartuar;
- Ekzistenca dhe harmonizimi i të dhënave nëpër njësitë vendore janë thelbësore për të krahasuar drejtpërdrejt të dhënat. Këto aspekte janë sfiduese por gjithashtu të domosdoshme për vetëvlerësimin e bashkive dhe të mësuarit nga aktivitetet e homologëve të tyre;
- Ekziston një debat i vazhdueshëm në lidhje me dy opsione që shënojnë progress në arritjen e OZhQ, vendosja e përparësive të matshme ose investimi për të marrë të dhëna të reja për të matur tregues të rëndësishëm për arritjen OZhQ.
- Treguesit e disponueshëm mund të jenë pak a shumë të rëndësishëm për bashki të ndryshme, duke pasur parasysh kontekstin lokal, ose mund të ndryshojnë pak ose aspak me kalimin e kohës;
- Të dhënat zakonisht merren nga sektorë të ndryshëm të bashkive dhe shpesh nuk janë në dispozicion në formatin e duhur.

Komponentët kryesorë të VVL

Sfidat e përmendura në paragrafët e mëparshëm janë vetëm disa nga ato me të cilat përballen bashkitë kur fillon procesi i VVL. Meqë ende nuk kemi një kornizë zyrtare të rënë dakord për raportimin lokal, shumica e bashkive kanë ndjekur shembuj të mëparshëm.

Katër hapa kryesorë fillestarë mund të identifikohen në përvojën e lokalizimit të OZhQ:

- Inicimi i një procesi gjithëpërfshirës dhe me pjesëmarrje;
- Vendosja e përparësive në Axhendën lokale;
- Planifikimi i zbatimit të OZhQ;
- Monitorimi dhe vlerësimi i treguesve të OZhQ.

Pasi një kornizë standarde lokale e treguesve të OZhQ nuk ekziston, bashkitë që kanë publikuar VVL kanë përdorur korniza të veta, duke iu referuar treguesve të OZhQ vetëm në pak raste. Kjo do të thotë se ka një mungesë të krahasueshmërisë midis bashkive.

Në rastin më të mirë, një VVL duhet të jetë i saktë, i replikueshëm dhe i përballueshëm me kalimin e kohës (të paktën çdo tre vjet); bazuar në analizën e të dhënave; dhe të jetë i krahasueshëm me bashkitë e tjera të vendit dhe në Evropë.

Disa sugjerime që duhet të merren parasysh kur filloni procesin e VVL:

- VVL është vullnetar, pra një angazhim i qartë mbi transparencën dhe llogaridhënien nga Kryetari i Bashkisë;
- VVL mund të jetë tre llojesh, përfshirë: (1) një përmbledhje e të gjitha OZhQ, (2) një përzgjedhje e OZhQ me rëndësi të veçantë për bashkinë, ose (3) vetëm OZhQ nën shqyrtim në Forumin Politik të vitit përkatës.
- Procesin e VVL duhet të jetë i planifikuar mirë në të gjitha fazat e tij pasi mund të zgjasë rreth shumë muaj.
- Mund të përdoren procese të ndryshme të menaxhimit: të drejtohet kryesisht nga stafi i ngushtë i kryetarit të bashkisë duke krijuar një grup pune të brendshëm.
- Për një bashki me Sistemi të Informacionit (GIS), mbledhja e të dhënave dhe vlerësimi mund të rezultojë në një proces të përgjithshëm më të shpejtë.

Disa seksione të identifikuara në VVL botuar në dy vitet e fundit

VVL zakonisht ndjekin një strukturë të ngjashme:

- Fjala e hapjes - angazhimi i kryetarit të bashkisë dhe administratës;
- Përmbledhje ekzekutive - pikat kryesore;
- Prezantimi
- Zinxhiri organizativ dhe institucional;
- Sfidat;
- Metodologjia dhe të dhënat;
- Vlerësimi i OZhQ;
- Përfundime.

Metodologjia për zgjedhjen e treguesve

Siç u përmend më lart, sfida kryesore për bashkitë qëndron në identifikimin e treguesve dhe të dhënave për t'u përdorur. Ky manual ofron një gamë të gjerë të shembujve të treguesve urbanë që mund të përdoren nga bashkitë për VVL. Ky paragraf ilustron kriteret e përdorura për zgjedhjen, si dhe llojet e treguesve të paraqitur dhe të dhënat e tyre.

Kriteret

Kriteret e përdorura për të zgjedhur treguesit urbanë për OZhQ në Evropë janë:

- Përshtatja me Kuadrin e Treguesve Globalë për Shtetet Anëtare të OKB-së.
- Rëndësia për kontekstin evropian. Koherenca midis disa treguesve dhe grupi të treguesve të BE-së përdorur në nivelin kombëtar nga Eurostat, lejon një përdorim më të zgjeruar të të dhënave dhe shfaqjen e modeleve territoriale.

- Relevanca në nivel lokal. Disa tregues të OZhQ nga Korniza Globale e Treguesve të OKB anë përcaktuar për shkallën kombëtare, ndërsa qëllimi i këtij manuali është të propozojë treguesit lokalë të rëndësishëm. (psh përqindja e grave në këshill bashkiak në bvend të grave në parlament).
- Përfshirja e fushave të veprimtarisë së njësive vendore. VVL dhe treguesit e tij duhet të jenë në gjendje të kapin kontributin e bashkisë drejt OZhQ: prandaj është e rëndësishme të merren parasysh kompetencat e autoriteteve lokale.
- Numri i qyteteve dhe disponueshmëria në vende të ndryshme. Fakti që një tregues është i gjendshëm për një numër të madh bashkish, lejon më pas krahasueshmërinë.
- Afatet kohore, kohëzgjatja dhe krahasueshmëria me kalimin e kohës. Një afat i gjatë kohor lejon studimin e trendeve me kalimin e kohës, dhe vlerësimin e progresit të bërë. Koha nga mbledhja e të dhënave tek publikimi i treguesit duhet të jetë sa më e shkurtër e mundur.
- Mundësia e mbledhjes dhe prodhimit të të dhënave me kalimin e kohës. Ndërsa treguesit ad-hoc, të marra nga sondazhet dhe kërkimet specifike mund të jenë të dobishme, zgjedhja duhet të favorizojë ato për të cilat prodhimi i të dhënave është i vazhdueshëm dhe i planifikuar me kalimin e kohës.
- Të ekuilibruar. Treguesit e zgjedhur duhet të mbulojnë mjedisin, shtyllat sociale dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm - në një mënyrë të ekuilibruar.

Llojet e treguesve të propozuar

1. Treguesit zyrtarë, të harmonizuar në nivel evropian, i prodhuar zakonisht nga institucionet europiane apo ndërkombëtare, të cilat tashmë janë në dispozicion për përdorim (d.m.th. OZhQ 3 vdekshmëria e foshnjave).
2. Treguesit eksperimentalë, të harmonizuar dhe në dispozicion për një numër të konsiderueshëm bashkish: këto zakonisht prodhohen nga institucione të besueshme evropiane dhe janë lehtësisht të disponueshme (d.m.th. OZhQ 13 - JRC - Indeksi i Rrezikut nga Përmbytjet).
3. Treguesit zyrtarë, të pa harmonizuar, të mbledhur nga vendet ose njësitë lokale: këta tregues shtjellohen dhe shpërndahen si Statistikat Zyrtare nga zyrat lokale statistikore ose administratata e bashkive sipas situatave të tyre specifike (d.m.th. OZhQ 12 - Mbetje urbane për frymë).
4. Treguesit lokalë eksperimentalë: treguesit e prodhuar nga bashkitë ose organizata / institucione individuale përmes metodave inovative dhe eksperimentale. Këta tregues janë propozuar në këtë Manuali si shembull dhe për të nxitur autoritetet lokale. Ata mund të ndihmojnë në përshkrimin e situatave specifike lokale, duke vlerësuar sfidat e veçanta lokale, dhe çështjet që lidhen me specifikën e secilës bashki (d.m.th. OZhQ 1 - Të pastrehët).

Pjesa 2: Dimensioni lokal i Axfordës 2030



Objektivi 1

Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj

Përshkrimi

Çrrënjësja e varfërisë në të gjitha format dhe dimensionet e saj njihet si sfida më e madhe dhe një kërkesë e domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm.

Për shembull, varfëria kufizon mundësitë e njerëzve për të arritur potencialin e tyre të plotë, me pasojat si në aspektin e kohezionit shoqëror dhe në rritjen e qëndrueshme. Varfëria është shumëdimensionale si koncept dhe lidhet me aspektet ekonomike, sociale, mjedisore, kulturore dhe politike.

Objektivat specifikë të Qëllimit 1 përqendrohen në: çrrënjësinë e varfërisë ekstreme, duke ju kundërvënë përfundimisht ekzistencës së kurtheve të varfërisë (Kraay dhe McKenzie 2014; Duflo dhe Banerjee 2011); përgjysmimi i varfërisë në të gjitha format; duke siguruar që të gjithë njerëzit të gëzojnë një standard bazë jetese dhe mbrojtje sociale; dhe rritjen e rezistencës në përballjen me katastrofat natyrore (Hallenatte et al. 2017).

Dimensioni lokal

Njësitë vendore janë aktorët më të përshtatshëm për të identifikuar grupet e prekshme, veçanërisht për grupe të vështira për t'u matur si të pastrehët (James D. Wright 1992). Për këtë arsye, niveli bashkiak mund të jetë më i informuari lidhur me nevojën për lehtësimin e varfërisë, me koordinimin dhe mbështetjen e nivele më të larta të qeverisjes.

Në veçanti, njësitë vendore mund t'i kundërvihen varfërisë duke vepruar në dy tipologji të kufizimeve ndaj individëve: kufizimet e jashtme si defekte institucionale ose qeveritare (Bardhan 1997), dhe kufizimet e brendshme, të tilla si sjellja dhe paragjykimet (Dalton, Ghosal, & Mani, 2016; Ëalto, 2004).

Bashkitë mund të synojnë të dy këta tregues të varfërisë duke shmangur që njerëzit të mbeten të varfër për shumë kohë ose tërë jetën e tyre e në këtë rast dhe fëmijët e tyre ka më shumë gjasa të përjetojnë varfëri.

Objektivi Specifik 1.2: Deri në 2030, të reduktohet me të paktën gjysmën e përqindjes të femrave, meshkujve dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri në të gjitha dimensionet e varfërisë bazuar në definicionin kombëtar.

Treguesi 1.2.1: Përqindja e personave me të ardhura të barabarta të disponueshme nën pragun e rrezikut të varfërisë, i cili është vendosur në 60% të të ardhurave mesatare të disponueshme mesatare të vendit (pas transfertave sociale).

Synimi: Reduktim me të paktën gjysmën e përqindjes së burrave, grave dhe të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri.

Objektivi Specifik 1.3 Zbatimi i sistemeve dhe masave të përshtatshme të mbrojtjes sociale kombëtare, për të gjithë dhe deri në vitin 2030 të arrihet mbulim i plotë me shërbime sociale të të varfërve dhe grupeve vulnerabël.

Treguesi 1.3.1 Përqindja e popullsisë e mbuluar me shërbime të mbrojtjes sociale, sipas gjinisë, duke dalluar fëmijët, personat e papunë, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna, të porsalindurit, viktimat e lëndimeve në punë dhe të varfërit dhe të prekshmit.

Objektivi Specifik 1.4 Deri në 2030, të sigurohet që të gjithë meshkujt dhe femrat, veçanërisht të varfërit dhe grupet vulnerabël, të kenë të drejta të barabarta për burimet ekonomike, si dhe akses në shërbimet bazë, pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe forma të tjera të pronës, trashëgimisë, burimeve natyrore, financiare, duke përfshirë mikrofinancën

Treguesi 1.4.1: Përqindja e personave që jetojnë në familje me akses në shërbimet bazë (ujë, kanalizime, kushtet e banesës, mbipopullimi, niveli arsimor i kryefamiljarit).

Përqindja e personave që vuan nga mungesa e aksesit në shërbimet bazë (ujë, kanalizime, kushtet e banesës, mbipopullimi, niveli arsimor i kryefamiljarit).

Përqindja e popullsisë që ka përfituar nga strehimi social përgjatë 2020.

Objektivi Specifik 1.5 Deri në vitin 2030, të përmirësohet jetesa e grupeve të varfra dhe atyre vulnerabël duke zvogëluar dëmin nga situata ekstreme të lidhura me klimën dhe katastrofave të tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Treguesi 1.5.4 Përqindja e njësive vendore që miratojnë dhe zbatojnë strategjitë lokale të zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat në përputhje me strategjitë kombëtare të zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat.

Treguesi 1.a.2 Përqindja e shpenzimeve totale të qeverisë për shërbimet thelbësore (arsimi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale).



Objektivi 2

Fund urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimin të të ushqyerit si dhe promovimi i bujqësisë së qëndrueshme

Përshkrimi

Qëllimi është ti jepet fund kequshqyerjes dhe gjithashtu të adresohen sfidat në lidhje me prodhimin dhe konsumin e qëndrueshëm të ushqimit.

Dimensioni lokal

Objektivi 2 trajton çështje që janë të rëndësishme për njësitë vendore - në veçanti: trajtimi i kequshqyerjes, duke iu afruar prodhimit të qëndrueshëm të ushqimit, sistemeve dhe menaxhimit të verifikuar dhe mirëfunksionimit të zinxhirit ushqimor.

Bashkitë mund të kontribuojnë drejt këtij qëllimi me: ofrimin e shërbimeve, përfshirë ushqimin për ata që nuk mund ta përballojnë; promovimi i dietave të shëndetshme dhe krijimin e proceseve të prokurimit që konsiderojnë nevojat për mbështetjen e konsumit të shëndetshëm dhe ushqimit të sigurt me një ndikim të ulët mjedisor.

Në zonat urbane, qeveritë lokale mund të zvogëlojnë mbeturinat e ushqimit dhe përmirësimin e sigurisë ushqimore. Bashkitë gjithashtu mund të promovojë bujqësi të qëndrueshme urbane si në nivelin individual ashtu edhe përmes projekteve të mëdha.

Objektivi specifik 2.1: Deri në vitin 2030, ti japim fund urisë dhe të sigurojmë akses nga të gjithë njerëzit, veçanërisht të varfërit dhe njerëzit në situata vulnerabël, përfshirë foshnjat, në ushqim të sigurt dhe të mjaftueshëm gjatë gjithë vitit.

Tregues: Ofrimi i ushqimit përmes menceve sociale për të pastrehët dhe të varfërit llogaritur me numrin e vakteve në ditë.



Objektivi 3

Shëndet i mirë dhe mirëqenie

Përshkrimi

“Shëndeti është një nga treguesit më efektivë të zhvillimit të qëndrueshëm të suksesshëm të çdo bashkie” (Organizata Botërore e Shëndetësisë 2016). Krahasuar me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit që përmendnin nevojën për të zvogëluar vdekshmërinë e foshnjave, përmirësuar shëndetin e nënës dhe luftën ndaj HIV / AIDS, malaries dhe sëmundjeve të tjera, OZhQ përfshijnë të gjitha çështjet e lidhura me shëndetin nën një qëllim, OZhQ 3, që përfshin shëndetin mendor, seksual dhe riprodhues, shërbime të kujdesit shëndetësor, çështje shëndetësore në lidhje me sëmundjet ngjitëse dhe jo-ngjitëse, ndotjen dhe aksidentet e trafikut rrugor.

Prandaj, Objektivi 3 përfshin të gjitha dimensionet e shëndetit nga karakteristikat dhe sjelljet individuale, faktorët socio-ekonomikë si dhe shërbime dhe kërkime për të parandaluar ose trajtuar dhe kuruar sëmundjet.

Dimensioni lokal

Kërkimet shkencore sugjerojnë se ekzistojnë diferencime në gjendjen shëndetësore nisur nga vendbanimet, qofshin ato urbane, rurale apo të largëta. Disavantazhi në vendndodhje mund të ndikojë në aftësinë individuale për të përmirësuar kushtet e jetesës, duke mohuar aksesin e lehtë në mbështetje sociale dhe kujdes shëndetësor. Edhe duke udhëtuar në distanca të vogla për të marrë këto shërbime mund ta vështirësojë qasjen në kujdes për njerëzit pa mjete transporti të përshtatshme dhe të sigurt.

Bashkitë mund të kenë një rol të rëndësishëm për të adresuar sfidat shëndetësore. Për shembull, ndërhyrje urbane dhe mjedisore, planifikimi dhe ofrimi i transportit, mund të ndikojë fuqishëm në uljen e rrezikut (Giles-Corti et al. 2016).

Për më tepër, cilësia e ndërtesave, niveli i mbipopullimit dhe kostoja përkatëse e strehimit mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në shëndet. Strehimi me cilësi të dobët shoqërohet me prevalencë të rritur të alergjive dhe sëmundje inflamatorë të mushkërive, të tilla si astma.

incidenca e sëmundjeve infektive dhe numri i vdekjeve aksidentale janë gjithashtu të lidhura pozitivisht me nivele të larta të mbipopullimit (Lloyd, Neëell, dhe Dietrich 2004).

Për shembull, shëndeti i dobët është i përqendruar në lagje të caktuara: duket se shëndeti më i keq gjendet mes më të varfërve. Është me të vërtetë e nevojshme të shikohen treguesit shëndetësorë të ndarë sipas të ardhurave ekonomike, lagjeve dhe kushteve sociale në mënyrë që sfidat shëndetësore të të pafavorizuarve të mos anashkalohen (Organizata Botërore e Shëndetësisë; dhe UN-Habitat 2010).

“Për të parë tërë shtrirjen e pabarazive në shëndetin urban është e rëndësishme të përpunohen tregues mbi shëndetin dhe mbi faktorët që ndikojnë në të (Organizata Botërore e Shëndetësisë; dhe UN-Habitat 2010).

Tregues të përkujdesit shëndetësor: Numri i institucioneve shëndetësore shtetërore dhe institucioneve të përkujdesjes sociale.



Objektivi 4

Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxëniet gjatë gjithë jetës për të gjithë.

Përshkrimi

Objektivi 4 synon që të gjithë njerëzit të kenë qasje në arsim cilësor dhe mundësi për të mësuar. Objektivi shkon përtej të dhënave rreth regjistrimit në shkollë dhe shikon si disponueshmërinë e mësuesve të trajnuar dhe objekteve shkollore të përshtatshme dhe pabarazi në rezultatet e arsimit (Kombet e Bashkuara 2017, E / 2017/66: 5).

Dimensioni lokal

Në shumë vende, arsimi fillor dhe i mesëm janë nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të njësive vendore, pasi ato janë më të përshtatshmet për të identifikuar nevojat specifike lokale. Një sistem i mirë dhe efikas arsimor në nivel lokal siguron baza më të mira për integrim të qytetarëve nga grupet vulnerabël, e në veçanti nga ata me aftësi të kufizuara, migrantët dhe pakicat.

Shkollat inkurajojnë integrimin dhe njohuritë e ndërsjella dhe përmes edukimit dhe trajnimit, bashkitë mund të përmirësojnë punësimin e nxënësve dhe gjendjen ekonomike. Për më tepër, qytetet dhe autoritetet lokale kanë një potencial të madh për të zbatuar veprime inovative për të siguruar arsim gjithëpërfshirës dhe mund të ofrojnë mundësi për të mësuar gjatë gjithë jetës të përshtatura me nevojat e sistemeve vendore të prodhimit.

Objektivi Specifik 4.1 Deri në vitin 2030, të gjitha vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm pa pagesë, të barabartë dhe cilësor, duke çuar në rezultate efektive të të nxëniet.

Treguesi 4.1.1 Përqindja e fëmijëve dhe të rinjve: (a) në klasat 2/3; (b) në fund të fillores; dhe (c) në fund të arsimit të mesëm të ulët, të paktën me një nivel minimal të aftësisë në (i) lexim dhe (ii) matematikë, sipas gjinisë.

Treguesi 4.1. 2 Përqindja e popullsisë 18-24 vjeç që përfunduar arsimin fillor, 9-vjecar dhe të mesëm.

Objektivi Specifik 4.2 Deri në vitin 2030, të gjitha vajzat dhe djemtë të kenë qasje në kujdes ditor dhe arsimin parashkollor, në mënyrë që ata të jenë gati për arsimin fillor.

Treguesi 4.2.2 Përqindja e fëmijëve të regjistruar në parashkollor dhe kopshte, sipas gjinisë. Përcaktohet si përqindja e fëmijëve në intervalin e caktuar të moshës që marrin pjesë në një ose më shumë program të organizuar të të mësuarit, përfshirë programet që ofrojnë një kombinim të arsimit dhe kujdesit ditor.

Objektivi Specifik 4.5 Deri në vitin 2030 të arrihet eliminimi i pabarazive gjinore në arsim dhe sigurimi i qasjes së barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe formimit profesional duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe fëmijët në situata të cënueshme.

